

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7039
E shtunë, 4 nëntor 2023
Çmimi 0.50

Blinkeni në Tel Aviv: Ka rëndësi se si mbrohet Izraeli

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRIT ALBIN KURTI KA RAPORTUAR NË KUVEND PËR TAKIMIN
E FUNDIT NË BRUKSEL NË LIDHJE ME DIALOGUN KOSOVË - SERBI

KURTI DHE OPOZITA ME AKUZA PËR DRAFT-STATUTIN E RI TË ASOCIACIONIT

FAQE 4-5



Kryeministri Albin Kurti ka raportuar të premtën para deputetëve të Kuvendit të Kosovës për takimin e fundit në Bruksel në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi, veçanërisht për gatishmërinë e tij për ta

nënshkruar draft-statutin për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, i paraqitur nga diplomatët ndërkombëtarë, por që atë e ka refuzuar Serbia. Deputetët e partive opozitare kanë drejtuar

akuza ndaj Kurtit për mospublikimin e dokumentit të këtij draft-statuti të Asociacionit dhe kanë kërkuar nga Kurti të tregojë nëse asociacioni, bazuar në këtë draft-statut, është një lloj autonomie

SPECIALJA ARRESTON ISNI KILAJN, REAGON KOMUNA E MALISHEVËS

FAQE 3



'DREJTËSI PËR BABIN', 'PROKURORI, MOS FLE', KËRKOHE DREJTËSI PËR ASTRIT DEHARIN

FAQE 6



AKTUALE



SHBA-ja MBËSHTET SPAK-UN:
REFORMA NË DREJTËSI
NË SHQIPËRI PO JEP REZULTATE F. 2

GJIGANTI METALURGJIK
"FERRONIKELI" NJOFTON
NDËRPRERJEN E PËRKOHSHME
TË PRODHIMIT F. 2

KONJUFCA VLERËSON RËNDËSINË E
ANËTARËSIMIT SA MË TË SHPEJTË TË
KOSOVËS NË KËSHILL TË EVROPËS F. 7

EKONOMI



MINATORËT E "TREPÇËS"
NDËRPRESEN GREVËN F. 8

DËSHTON SËRISH KONSTITUIMI
I KOMISIONIT HETIMOR
PËR REZERVAT SHTETËRORE F. 8

SPORT



XHUDISTET I SJELLIN KOSOVËS
DY MEDALJE NGA FRANCA F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fac: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Blinkeni në Tel Aviv: Ka rëndësi se si mbrohet Izraeli

TEL AVIV, 3 NËNTOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Anthony Blinken, tha se Shtetet e Bashkuara "qëndrojnë fort me Izraelin". "Izraeli ka të drejtën dhe detyrimin për ta mbrojtur veten dhe për të siguruar që ngjarjet e 7 tetorit të mos përsëriten kurrë", tha Blinkeni më 3 nëntor në Tel Aviv pas një takimi me presidentin izraelit Isaac Herzog. Blinkeni qëndroi të premtën në Izrael për të bërë presion që më shumë ndihmë humanitare të lejohet të hyjë në Gazën e rrethuar, përderisa trupat izraelite kanë ashpërsuar rrethimin e tyre të qytetit të Gazës për ta fokusuar fushatën e tyre në shtypjen e grupit militant Hamas, që udhëheq këtë enklavë.

Kreu i diplomacisë amerikane tha në të njëjtën kohë se "është e rëndësishme se si e bën Izraeli" - dhe se është e rëndësishme të bëjmë gjithçka për t'i mbrojtur civilët "të kapur në zjarrin e krijuar nga Hamasi".

Më 7 tetor organizata militante palestineze Hamas kreu sulme në të cilat, sipas zyrtarëve izraelitë, u vranë më shumë se 1 400 njerëz dhe më shumë se 200 u rrëmbyen.

Ministria e Shëndetësisë e Gazës, e cila drejtohet nga Hamasi, thotë se më shumë se 9 000 njerëz në Rripin e Gazës janë vranë në sulmet izraelite që nga 7 tetori.

ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian e kanë cilësuar Hamasin si organizatë terroriste.

Blinkeno theksoi se ndihma duhet të arrijë te qytetarët e Rripit të Gazës të cilët kanë nevojë dëshpërimisht për të.

Kurse presidenti izraelit tha se para sulmit, forcat e tij të armatosura i paralajmëruan banorët e Gazës duke dërguar

gjashtë milionë mesazhe me tekst, duke bërë katër milionë telefonata dhe duke shpërndarë 1.2 milion pamflete.

Herzog tha se Izraeli i bindet ligjit ndërkombëtar, duke përfshirë paralajmërimin e civilëve përpara sulmit në kampin e refugjatëve Jabaliya - i cili vrau dhjetëra njerëz në Gazën veriore, duke përfshirë një komandant të Hamasit.

Komentet e Blinkenit u bënë pasi sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, tha se në Gaza ishte kryer një "shkelje e qartë e ligjit ndërkombëtar". Gjatë vizitës së tij në Izrael, Blinkeni u takua edhe me kryeministrin Benjamin Netanyahu.

Në kufirin verior me Libanin, tensionet po vazhdojnë të përshkallëzohen para fjalimit të planifikuar për më vonë gjatë së premtes të liderit të Hezbollahit, Hassan Nasrallah.

Ky do të jetë fjalimi i tij i parë qëkur Hamasi sulmoi Izraelin muajin e kaluar, duke nxitur frikën se konflikti Izrael - Hamas mund të shndërrohet në një konflikt rajonal.

Të enjten Hezbollahu, aleat i Hamasit, sulmoi pozicionet izraelite në veri duke kryer sulme me dronë, mortaja dhe me dronë vetëvrasës. Ushtria izraelite tha se është kundërpërgjigjur me sulme me avionë dhe helikopterë luftarakë.

Që kur lufta në Gazë nisi më 7 tetor, Hezbollahu ka ndërmarrë hapa të kalkuluar për ta angazhuar ushtrinë izraelite në kufi me Libanin, por deri më tani nuk ka pasur ndonjë përshkallëzim që do të nxiste një luftë.

Kjo është vizita e tretë e Blinkenit në Izrael që nga sulmi i Hamasit dhe i zhvilluar pak pasi



presidenti amerikan, Joe Biden, sugjeroi për një "pauzë" humanitare të luftimeve.

Izraeli nuk është përgjigjur menjëherë për sugjerimin e Bidenit, por kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu

paraprakisht kishte hedhur poshtë mundësinë e armëpushimit dhe të mërkurën tha se "ne po avancojmë... asgjë nuk do të na ndalë", përderisa u zotua se do ta shkatërrojë Hamasin.

Para nisjes së Blinkenit drejt Izraelit, Departamenti amerikan i Shtetit përsëriti "mbështetjen amerikane për të drejtën e Izraelit për ta mbrojtur veten".

Në të njëjtën kohë, administrata Biden kërkoi që Izraeli të lejojë më shumë ndihmë në Gazë pas rritjes së shqetësimeve për një krizë humanitare në këtë territor. Mbi 3 700 fëmijë palestinezë janë vranë në 25 ditët e para të luftimeve, sipas Ministrisë së

Shëndetësisë në Gazën e udhëhequr nga Hamasi. Bombardimet kanë detyruar mbi gjysmën e popullsisë prej 2.3 milionë banorësh që të largohen nga shtëpitë e tyre. Furnizimet me ujë, ushqime dhe karburante janë pakësuar për shkak të rrethimit të Izraelit dhe shumica e spitaleve janë buzë kolapsit.

Izraeli ka lejuar mbi 260 kamionë me ushqime dhe ilaçe të hyjnë në Gazë por, sipas punëtorëve të ndihmës, kjo sasi e ndihmës nuk është e mjaftueshme. Autoritetet izraelite kanë refuzuar ta lejojnë dërgimin e furnizimeve me karburante, duke thënë se Hamasi do t'i përdorte karburantet për përdorime ushtarake.

Zëdhënësi për siguri kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, John Kirby, tha se ShBA-ja nuk po kërkon një armëpushim të përgjithshëm, por një "pauzë" të përkohshme dhe të lokalizuar".

Izraeli dhe ShBA-ja duket se nuk kanë një plan të qartë se çfarë do të ndodhë më pas nëse Hamasi - që udhëheq Gazën - do të mposhtet. Kjo do të jetë një pyetje kyçe në agjendën e Blinkenit gjatë kësaj vizite, tha DASH-i.

Më herët gjatë javës, Blinkeni ka sugjeruar që Autoriteti Palestinez ta qeverisë Gazën. Hamasi e kishte larguar nga pushteti Autoritetin Palestinez më 2007, kur mori kontrollin e territorit. Autoriteti Palestinez tani ka fuqi të kufizuara në disa pjesë në Bregun e pushtuar Perëndimor. Zyrtarët ushtarakë dhe forcat izraelite tani kanë rrethuar plotësisht qytetin e Gazës, një zonë e banuar që Izraeli ka thënë se është qendër e infrastrukturës ushtarake të Hamasit, ku përfshihet edhe rrjeti i gjerë i tuneleve nëntokësore, bunkerëve dhe qendra komanduese.

Të paktën 12 persona humbën jetën në Evropë nga stuhia Ciaran



MADRID, 3 NËNTOR - Të paktën 12 persona kanë vdekur pasi stuhia Ciaran goditi Evropën Perëndimore me erëra rekord deri në 200 kilometra në orë, duke shkaktuar kaos trafiku pasi portet u mbyllën, kurse udhëtimet me tren dhe avionë u anuluan.

Pesë persona kanë vdekur në Toskanë, njoftuan të premtën autoritetet italiane, duke thënë se ishte shpallur gjendje e jashtëzakonshme për shkak të reshjeve rekord. "Ajo që ndodhi sonte në Toskanë ka një emër: ndryshimi i klimës", shkroi guvernatori i Toskanës, Eugenio Giani, në rrjetin X.

Kryetari i Bashkisë së Firences, Dario Nardella, tha se "situata është kritike" në atë qytet.

Mbrojtja civile e Italisë tha se 200 milimetra shi ranë brenda tri orëve, nga qyteti bregdetar i Livornos deri në luginën e brendshme të Mugello, duke shkaktuar daljen e lumenjve nga shtretërit e tyre.

Pemët që u rrëzuan nga erërat e stuhishme shkaktuan shumicën e vdekjeve në Evropë. Në qytetin belg të Gentit, një djalë pesëvjeçar nga Ukraina dhe një grua 64-vjeçare vdiqën nga rënia e degëve.

Nga rrëzimi i pemëve, më herët, u mbyt një shofer kamioni në

rajonin Ain të Francës veriore. Autoritetet franceze njoftuan gjithashtu për vdekjen e një burri që ra nga ballkoni i tij në qytetin port të Avros.

Një burrë në qytetin holandez Venraj, një grua në qendër të Madridit dhe një person në Gjermani kanë vdekur, gjithashtu. Rreth 1.2 milion shtëpi franceze mbetën pa energji elektrike pasi stuhia goditi bregun veriperëndimor.

Stuhia shkaktoi ndërprerje në trafikun hekurudhor, atë ajror dhe detar në Belgjikë, me portin e Antwerpit të mbyllur dhe fluturimet e anuluar nga Brukseli.

Specialja arreston Isni Kilajn, reagon komuna e Malishevës

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Ish-kryetari i komunës së Malishevës, Isni Kilaj, është arrestuar me urdhër të Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë. Paraprakisht policia e EULEX-it ka bastisur shtëpinë e Kilajt. Komuna e Malishevës në një njoftim për medie ka theksuar se është e shqetësuar për arrestimin e ish-kryetarit të komunës, Isni Kilaj. "Ne si komunë besojmë dhe jemi thellë të bindur se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka qenë luftë e pastër dhe mbi të gjitha ka qenë luftë çlirimtare, madje lufta e popullit të Kosovës, është lufta më e pastër që ka ndodhur ndonjëherë në histori të njerëzimit", thuhet në njoftimin e Komunës së Malishevës. Kjo komunë ka kërkuar që Gjykata Speciale ta ndërpresë këtë mënyrë të përndjekjes së çlirimtarëve dhe, në të njëjtën kohë, ka kërkuar që kjo gjykatë dhe gjykatat e tjera kompetente, përfshirë edhe Tribunalin e

Hagës, që të merret me ndjekjen, arrestimin dhe dënimin e autorëve të vrasjes së afër 400 civilëve të komunës së Malishevës gjatë viteve 1998-1999 nga ushtria dhe policia e shtetit të Serbisë. "Kujtojmë se në territorin e komunës së Malishevës janë vrarë afër 400 civilë të pafajshëm, madje janë vrarë në mënyrën më mizore të mundshme dhe deri më sot, nuk është dënuar askush dhe nuk është zhvilluar asnjë proces gjyqësor për këto vrasje, as për dy masakrat e mëdha, atë të Burimit dhe të Gollubovcit. Edhe njëherë, shprehim shqetësimin tonë për këto veprime të pandërprera të Gjykatës Speciale dhe policisë së EULEX-it, për përndjekjen e luftëtarëve të lirisë dhe kërkojmë ndërprerjen e menjëhershme të këtyre arrestimeve të pakuptimta. Isni Kilaj, dhe të gjithë bartësit e luftës çlirimtare, janë të pafajshëm dhe të gjitha këto veprime të gjykatave, i



konsiderojmë si veprime politike, që për qëllim kanë njoftimin e luftës për çlirim", theksohet tutje në njoftim. Komuna e Malishevës ka kërkuar lirimin e menjëhershëm

të Kilajt dhe të krerëve të luftës së UÇK-së si dhe ka kërkuar të ndërpriten këto veprime të turpshme. "Ne besojmë në drejtësi, por drejtësi duhet të ketë për të gjithë. Lufta e UÇK-së

është luftë e njohur nga të gjithë, luftë e cila i ka sjellë lirinë dhe pavarësinë Kosovës", thuhet në njoftimin e komunës së Malishevës, kryetar i së cilës është Ekrem Kastrati.

ShBA-ja mbështet SPAK-un: Reforma në drejtësi në Shqipëri po jep rezultate

TIRANË, 3 NËNTOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës shprehën mbështetjen për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) dhe reformën në drejtësi në Shqipëri. Ndhimëssekretari i Departamentit të shtetit për Çështjet Evropiane dhe Euroazisë, Jim O'Brien, u takua me prokurorët e SPAK-it, të cilët prej disa ditësh ndodhen në ShBA në një vizitë studimore ku do të takohen me zyrtarë të lartë amerikanë. Përmes një postimi në platformën X, O'Brien theksoi se reforma në drejtësi në Shqipëri po jep rezultate dhe duhet të jetë e qartë se askush nuk është mbi ligjin. "I kënaqur që takova shefin e SPAK-it, Altin Dumanin. Është mbresëlënëse ta shohësh



reformën në drejtësi që jep rezultate reale për popullin shqiptar, duke treguar me

veprime se askush nuk është mbi ligjin", shkroi O'Brien. Ai theksoi se ShBA-ja do të

vazhdojë ta mbështesë fuqishëm reformën në drejtësi, të cilën e vlerësoi si thelbësore për të ardhmen e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në takim ka qenë e pranishme dhe ish-ambasadorja amerikane në Shqipëri, Yuri Kim, e cila aktualisht është zëvendësndihmëssekretare kryesore e Shtetit për Çështjet e Evropës dhe Euroazisë. Prej disa ditësh drejtuesi i SPAK-it, Altin Dumanin, së bashku dhe me disa prokurorë të SPAK-it, ndodhen në Uashington. Ata do të kenë takime edhe me përfaqësues të Departamentit amerikan të Shtetit, Departamentit të Drejtësisë, Administratës Kundër Narkotikëve (DEA) dhe Byrosë Federale të Hetimit (FBI). Aktualisht SPAK është duke hetuar disa dosje, ku janë të

përfshirë edhe zyrtarë dhe ish-zyrtarë të lartë në Shqipëri. SPAK-u është duke hetuar privatizimin e ish-kompleksit sportiv "Partizani" dhe gjykata ka caktuar masën e sigurisë "detyrim paraqitje" për ish-kryeministrin Sali Berisha nën dyshimet se përmes disa vendimeve dhe ligjeve ka favorizuar dhëndrin e tij, Jamarbër Malltezi. Hetime po kryhen edhe për dosjen "Gërdeci" për të cilën janë marrë në pyetje ish-ministri Fatmir Mediu dhe ish-ushtarakë, por edhe për disa çështje të tjera, për të cilat janë paraqitur në SPAK edhe ministra aktualë dhe kryebashkiakë. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar u ngrit në dhjetor të vitit 2019 me qëllim hetimin e korrupsionit në nivelet e larta dhe krimin e organizuar.

Loja e Speciales, të mërkurën e ftoi "Remin" për intervistim, të enjten e anuloi

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Zyrtarët e Dhomave të Veçanta të Prokurorisë Speciale të Kosovës të mërkurën i kanë dërguar ftesë për intervistim Rrustem Mustafës-"Remin", njërit prej komandantëve të UÇK-së. Të enjten zyrtarët e Dhomave të Veçanta të Prokurorisë Speciale të Kosovës, edhe nëpërmjet thirrjes telefonike, edhe nëpërmjet emailit, e kanë njoftuar Mustafën se intervistimi i tij është

anuluar. "Në lidhje me këtë çështje dua ta konfirmoj edhe një herë përcaktimin e përkushtimit tim. Si në të kaluarën ashtu edhe sot, por edhe nesër e kurdo që është nevoja, jam i gatshëm për të dhënë kontributin tim në favor të drejtësisë. Lufta e UÇK-së ka qenë luftë mbrojtëse dhe çlirimtare, ashtu siç thonë edhe miqtë ndërkombëtarë. Luftë më të drejtë dhe më të pastër (për aq sa, pastërtinë e tillë e

mundësojnë rrethanat e luftës) nuk njih historia e njerëzimit. Jam me fat që kam qenë njëri nga protagonistët e kësaj lufte, dhe të vërtetën e saj jam i gatshëm ta mbroj në çfarëdo cilësie. Falë luftës së UÇK-së, jo vetëm Kosovës por edhe rajonit, i është hapur rruga e integritit në familjen evropiane, aty ku e kemi vendin ne si komb dhe si shoqëri", ka shkruar Mustafa në "Facebook".





KRYEMINISTRIT ALBIN KURTI KA RAPORTUAR NË KUVEND PËR TAKIMIN E FUNDIT NË BRUKSEL NË LIDHJE ME DIALOGUN KOSOVË - SERBI

Kurti dhe opozita me akuza për draft-statutin e ri të asociacionit

Kryeministri Albin Kurti ka raportuar të premten para deputetëve të Kuvendit të Kosovës për takimin e fundit në Bruksel në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi, veçanërisht për gatishmërinë e tij për ta nënshkruar draft-statutin për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, i paraqitur nga diplomatët ndërkombëtarë, por që atë e ka refuzuar Serbia. Deputetët e partive opozitare kanë drejtuar akuza ndaj Kurtit për mospublikimin e dokumentit të këtij draft-statuti të Asociacionit dhe kanë kërkuar nga Kurti të tregojë nëse asociacioni, bazuar në këtë draft-statut, është një lloj autonomie

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se draft-statuti për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, i paraqitur nga diplomatët ndërkombëtarë, ka qartësi sa i përket njohjes së Kosovës. “E para, drafti në vlerësimin tim politik e ndërpret trashëgiminë mosnjohëse të Republikës së Kosovës që ishte çimentuar në marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015. Pra, në gjykimin tim politik, drafti ka një qartësi sa i përket njohjes së Republikës së Kosovës, si një shtet i pavarur në të cilin serbët do të jetojnë në përputhje me aspiratat multietnike të Kushtetutës dhe pa qëllim tjetër dëmtoes minus për Republikën në njohje të shtetit sovran dhe të

integritetit tonë territorial”, ka thënë Kurti, i cili me kërkesë të partive opozitare ka raportuar të premten para deputetëve të Kuvendit për draft-statutin e propozuar nga ndërkombëtarët për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë dhe për takimet e fundit në Bruksel. Sipas tij, kjo qartësi nuk paraqet “Zajednicën” (v.j. që në gjuhën serbe do të thotë Asociacion) të paraparë në marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015, sepse “asisoj do të ishte i padiskutueshëm”. Ai, megjithatë, tha se draft-statutin zyrtarisht ende nuk e ka pranuar. “Ta pranosh nënkupton të pajtohesh që të ndërmarrësh obligime për zbatimin e draftit”, ka thënë ai, duke shtuar se ai ka ofruar ta nënshkruajë atë dhe, “si rrjedhojë, ta pranoj”. Kurti ka thënë se draft-statuti është

shkruar me kujdes ndaj gërmës së Kushtetutës, më shumë sesa frymës së saj. Megjithatë, ai tha se në draft parashihet që ky dokument të shkojë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Kurti ka deklaruar para deputetëve se nuk mund të ofrojë detaje të draft-statutit, por mund të japë vetëm qëndrimin e tij politik. “E dyta, drafti në vlerësimin tim politik e bënë të qartë që mekanizmi që do të themelohet do të ketë karakter koordinues dhe bashkëpunues. Pra, nuk do parashikoj e as ndërhyjë në kompetencat e komunave të organeve qendrore e kështu me radhë. E treta, drafti ia mbyll hapësirën e përdorur nga Serbia që serbëve në Kosovë t’u projektojë një të ardhme jashtë kufijve të Kosovës apo në mosnjohje të kufijve të Kosovës e,

rrjedhimisht, ata të jetonin me ndjenjën e imponuar nga Beogradi për një luftë të re për territorin, a shkëmbim territorial a bashkim për këdo tjetër. Pra drafti e bënë të qartë që vendi është Republika e Kosovës dhe e ardhmja është bashkëjetesa në institucionet dhe në kufijtë e Republikës së Kosovës. Kjo i bie që Serbia do të duhej të hiqte dorë nga premisa që serbët në Kosovë jetojnë në Serbi apo që serbët në Kosovë mund të kenë aspirate shkëputëse territoriale apo autonomi jashtë Republikës së Kosovës, jashtë ligjeve dhe kushtetutës së Kosovës”, ka thënë ai. Sipas Kurtit, çdo ndryshim në statut të Asociacionit do të bëhet pasi të jetë pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e Kosovës, pasi Gjykata Kushtetuese të ketë dhënë aktgjykim lejues. “Kjo e përmbys atë që e ndërtonin marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015, përkatësisht supozimin që e krijonin ato që pjesëmarrësit në një asociacion do të jenë të lirë të avancojnë atë në një drejtim të panjohur. Një drejtim i tillë i panjohur më nuk ekziston dhe tash drejtimi është i qartë dhe i njohur. Ajo është Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Kapërcimet,

avancimet e tejkalimet nuk lejohen dhe nuk mund të ndodhin”, ka thënë Kurti. Ai ka shtuar se draft-statuti iu paraqit nga përfaqësuesit e “Pesëshes së Madhe” më 21 tetor në Prishtinë, të cilët, sipas tij, “më kërkuan garanci që draftin të mos e bëj publik për shkak që publikimi i tij do të keqpërdorej në dëm të kontributit të qeverive sponsorizuese”. Gjatë replikave Kurti tha se drafti është “pakrahasueshëm më i mirë” sesa marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015. “Përkundër kësaj, që është pakrahasueshëm më i mirë, me datën 24 tetor ia kam dërguar kritikën time dhe vërejtjet e mia emisarit evropian Lajcak, dy ditë para takimit në Bruksel”, ka thënë ai. Kurti u ka thënë deputetëve të opozitës se Serbia nuk po do të nënshkruajë me të asnjë marrëveshje e, sipas tij, Serbia ka nënshkruar me PDK-në dhe me LDK-në. Kurti, duke ironizuar me deputetët e opozitës, tha: “Aman më tregoni qysh ia keni bërë ju, që të mësoj edhe unë”. “Edhe njëherë po ritheksoj para të gjithë deputetëve dhe qytetarëve të Republikës me sa vijon: unë jam edhe i gatshëm për

Gjiganti metalurgjik “Ferronikeli” njofton ndërprerjen e përkohshme të prodhimit

Prishtinë, 3 nëntor - Korporata metalurgjike “NewCo Ferronikeli Complex LLC” njoftoi të premten se ka vendosur ta ndërpresë prodhimin përkohësisht vetëm katër muaj pasi ishte kthyer në punë pas një pauze të detyrueshme dyvjeçare.

“Ferronikeli”, i cili ndodhet në qytetin qendror të Kosovës, Drenas, rreth 34 kilometra larg kryeqytetit, Prishtinës, tha se po e ndërpret prodhimin për shkak të

rritjes së kostos së prodhimit dhe uljes së çmimeve të nikelit që prodhon. “Kjo krizë vjen si rezultat i çmimeve të ulëta në tregun botëror të nikelit dhe rrezikut nga një recesion për mallrat që parashikohen për vitin 2024. Ne detyrohemi ta marrim vendimin për ndërprerjen e përkohshme të prodhimit deri në një njoftim të dytë”, thuhet në një komunikatë të kësaj kompanie. Ajo tha se, përkundër “krizave të

papërballueshme për ta vazhduar procesin e prodhimit, kompania bashkë me punonjësit e saj do të gjejnë zgjidhje që kjo periudhë e vështirë të mos i dëmtojë 1 000 punonjësit e saj”. Kjo është hera e dytë që kjo kompani e ndal prodhimin brenda dy vjetëve dhe vetëm katër muaj pasi e kishte rinisur prodhimin. Ajo e kishte ndërprerë prodhimin nga tetori 2021 deri në qershor 2023,

asokohe për shkak të shtrenjtimit të energjisë elektrike në Evropë. Korporata metalurgjike prodhon dhe eksporton nikel nëpër shumë vende të botës.

“Ferronikeli” ka qenë kompani publike para se të privatizohet në vitin 2005. Në vitin 2018 ajo është blerë nga kompania e Shqipërisë, “Balfin Group”. Ndërkaq, rreth një vit më parë, ajo kaloi në pronësi të konsorciumit turk “Yildirim Group”.

“Ferronikeli” është ndër eksportuesit më të mëdhenj në Kosovë.

Në periudhën para pandemisë, në vitin 2019, kjo kompani kishte eksportuar nikel në vlerë prej 51 milionë eurosh. Nëse krahasohet kjo shumë me eksportin e përgjithshëm nga Kosova për vitin 2019 që është 383 milionë euro, i bie që “Ferronikeli” përbënte rreth 13 për qind të të gjithë eksportit në vend.



nënshkrim edhe i interesuar. Beogradi nuk po dëshiron të nënshkruaj me mua. Ka nënshkruar edhe me PDK-në, edhe me LDK-në. Mua po më ik, nuk po nënshkruan. Po shpall zgjedhje. Në dialogun tuaj ai ishte konstant e në Kosovë mbaheshin zgjedhjet. Tash unë jam konstant e në Serbi mbahen zgjedhjet. Qysh ia keni bërë që nënshkruante me juve? Ju tregoni qysh ia keni bërë në 2013-n. Ju tregoni qysh ia keni bërë në 2015-n. Më tregoni se qysh ia keni bërë, se jam i interesuar edhe unë për nënshkrim. Jam edhe i gatshëm edhe i interesuar. Tregoni! Merreni fjalën”, ka thënë Kurti.

Opozita, kritika për Kurtin

Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës në opozitë, Memli Krasniqi, ka kritikuar Kurtin që nuk tregoi hollësi për draft-statutin e Asociacionit. Ai ka thënë se me pranimin që ta nënshkruajë këtë draft, Kurti ka pranuar që Serbia të vendosë për rregullimin e

brendshëm të Kosovës. “Ta kanë sjellë një draft për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, bashkësinë, ‘Zajednicën’, dhe e ke pranuar. A mund të na tregosh çfarë ke bërë ti aty [në takimin në Bruksel] nëse nuk e ke pranuar. Së pari, kur ke thënë eja po e nënshkruajmë, ke bërë një gabim që një amator nuk është dashur ta bëjë. T’i thuash botës jam i gatshëm të nënshkruaj me Vuçiqin draftin e Asociacionit për Kosovën, që rregullon Kosovën brenda, është anormale të pranosh që Serbia të vendosë për rregullimin e brendshëm të Kosovës. Ta nënshkruash draftin e Asociacionit që duhet të miratohet nga qeveria që ju drejtoni e të gjykohej nga Gjykata Kushtetuese”, është shprehur Krasniqi, duke shtuar se për 19 minuta Albin Kurti e ka përmbysur komplet karrierën e tij politike më 26 tetor në Bruksel. “Pas dhjetë vjetëve kundërshtim, e pranoi Asociacionin pa asgjë në këmbim, me Zajednicë dhe autonomi politike për serbët në

qendër!”, ka thënë Krasniqi. Ndërkaq kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se për draft-statutin, Kurti dhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kanë dhënë qëndrime të ndryshme. “Gjersa kryeministri pretendon se statuti i Asociacionit të tij është në përputhje me Gjykatën Kushtetuese ose, së paku, kështu i kanë thënë atij, presidentja si pranuese e po të njëjtit dokument shpalos hezitimin për një cilësim të tillë dhe jo vetëm aq, njofton dërgimin e komenteve në Gjykatë Kushtetuese në rastin e parë, si shenjë e parë e mospërputhjes kushtetuese”, ka thënë ai. Presidentja Osmani ka thënë se nuk mund të japë vlerësim nëse dokumenti është në përputhje me Kushtetutën por, kur të nënshkruhet, ajo do t’i dërgojë mendimet e saj në Kushtetuese për këtë çështje. Abdixhiku ka thënë se pret që Kurti të tregojë nëse një Asociacion, bazuar në këtë draft-statut, do të ishte një lloj

autonomie. Sipas tij, ky dokument ose shkel Kushtetutën e Kosovës ose vijat e kuqe të Serbisë. Ai ka thënë se draft-statuti për Asociacionin nuk duhet të nënshkruhet me Serbinë “sepse është çështje e brendshme e Kosovës”.

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka kërkuar që Kurti të tregojë se cili është draft-statuti dhe jo që deputetët të informohen nga mediet. “E gjithë qasja e tij, prej ditës së parë deri në fund me dialogun, ka qenë eksperimentale. Llogaria dhe përgjegjësia bie te ju, në mënyrë që vendin tonë në këto rrethana jo të lehta ta shtyjnë përpara në dy tema që janë synime të AAK-së. E para ka të bëjë me anëtarësimin në NATO, e dyta që me eksperimentimet tuaja që i ke bërë edhe në veri, të kesh kujdes mos ta rrezikosh sovranitetin dhe rregullin kushtetues të Kosovës”, ka thënë ai. Tahiri ka theksuar se me klimën “toksike” të krijuar në dialog, me

apo pa dashje, Kurti ka kontribuar në interesin kryesor të Serbisë që, sipas tij, është status quo-ja.

Pas takimeve me liderët evropianë dhe të Bashkimit Evropian në Bruksel më 26 tetor, Kurti ka thënë se ka pranuar propozimin për draft-statutin e Asociacionit dhe ishte i gatshëm të nënshkruante marrëveshje për normalizimin e raporteve me Serbinë, por kjo ishte kundërshtuar nga presidenti serb Aleksandër Vuçiq.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Por më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me aktin më të lartë juridik të shtetit. Kosova deri më tani ka refuzuar të themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, duke shprehur frikën se mund ta cenojë funksionalitetin e shtetit. Serbia, ndërkaq, insiston në themelimin e tij.

"Drejtësi për babin", "Prokurori, mos fle", kërkohet drejtësi për Astrit Deharin

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Familjarë, qytetarë dhe aktivistë të premtën kanë protestuar para Prokurorisë Speciale duke kërkuar drejtësi për Astrit Deharin.

Më 5 nëntor bëhen shtatë vjet nga vdekja e aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje në burgun e Prizrenit, vdekje e cila nuk është zbardhur ende. "Prokurori, mos fle, heto rastin", "7 vjet për Astritin janë shumë", "Ne jemi Astrita"...

ishin disa nga pankartat që mbajtën në duar protestuesit. Në këtë aksion morën pjesë prindërit, bashkëshortja e vajza e tij, që në duar mbante një mbishkrim "Drejtësi për babin".

Avokati i familjes Dehari, Tomë Gashi, ka theksuar se Astriti ka vdekur në rrethana të pasqaruara. Sipas tij, dëshmitarët po mbahen të fshehtë nga Prokuroria e cila nuk po jep asnjë sqarim lidhje

me këtë rast. Ai ka thënë se edhe Instituti i Zvicrës ka dëshmuar që Astriti nuk ka bërë vetëvrasje.

Babai i Astrit, Avni Dehari, i cili është edhe deputet i Kuvendit të Kosovës, ka thënë se tashmë po bëhen 7 vjet që po kërkojnë drejtësi, duke shtuar se edhe arrestimi i tij ishte inskenim për qëllime politike. Ai ka pohuar se drejtësia është peng në duart e prokurorisë.



Kurti merr pjesë në ceremoninë e certifikimit të kursantëve holandezë

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në ceremoninë e certifikimit të kursantëve holandezë, në ambientet e Qendrës së Kërkim-Shpëtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Pomozotin, Fushë-Kosovë, ku të pranishëm ishin edhe ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Sylja, zëvendësambasadori i Holandës në Kosovë, Ronald Goldberg, komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneralbrigade Naim Haziri dhe drejtori i Qendrës së Kërkim-Shpëtimit, John Doone. Në hapje të kësaj ngjarje Kurti theksoi se trajnimi që sapo ka përfunduar është pjesë e një rrjeti global aktivitetesh që na mundësojnë t'i përgjigjemi me shpejtësi të papriturave dhe, duke e bërë këtë, të shpëtojmë jetë.

Teksa i uroi kursantët për këtë



arritje, siç është kjo e certifikimit, kryeministri Kurti u shpreh i lumtur që ishte pjesë e

kësaj ngjarje në festimin e kësaj arritje të rëndësishme për të gjithë pjesëmarrësit dhe për të gjithë

stafin që ndihmoi që ky ushtrim të realizohet me sukses të plotë. Në fjalën e tij Kurti tha se

përkushtimi i Kosovës për partneritet dhe vendosmëria e saj për të kontribuar në zgjidhjet e përbashkëta është thelbësore. Ai shtoi se është krenar për aftësitë e klasës botërore që i zhvillojmë në Pomozotin, aftësi që janë jetike për shtetin tonë dhe partnerët tanë tekса përgatitemi për role që na takojnë në arenën globale. Duke e cilësuar këtë si një moment shumë të veçantë, Kurti tha se kjo qendër vitin e kaluar ka ofruar trajnime për afër 3 000 persona, në mesin e të cilëve, krahas shtetasve tanë, edhe qindra partnerë tjerë të huaj nga Shqipëria, Britania e Madhe, Italia, Hungaria, Jordania, Malta, Maqedonia e Veriut, Irlanda e Veriut, Portugalia, Turqia si dhe kolegët e nga Holanda. "Ambicia jonë është ta ngrehim këtë qendër në një qendër të njohur ekselence, duke u shërbyer partnerëve tanë të Bashkimit Evropian dhe NATO-s, si dhe komunitetit më të gjerë global", tha Kurti.

ShBA-ja sanksionon ish-drejtorin e prokurimit në Ministrinë e Tregtisë, Nexhat Krasniqi



PRISHTINË, 3 NËNTOR - Departamenti amerikan i Shtetit ka vendosur në listën e sanksioneve Nexhat Krasniqin, ish-drejtorin e Departamentit të Prokurimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për shkak të përfshirjes në korrupsion të madh. Sipas njoftimit, atij do t'i ndalohet hyrja në ShBA. "Si zyrtar publik përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratave të prokurimit,

Krasniqi ka abuzuar me postin e tij publik duke pranuar rryshfet në këmbim të dhënies së kontratës për lejimin e ndërtimit të parkut industrial në komunën e Drenasit nga kompania 'Eltoni', u tha në njoftim, raporton REL-i. Sipas DASH-it, veprimet e sotme të ShBA-së dëshmojnë se Uashingtoni qëndron me ata në Kosovë që kërkojnë përgjegjësi nga zyrtarët e korruptuar

publikë. "Ky vendim riafrimon përkushtimin e ShBA-së për luftimin e korrupsionit që dëmton interesat publike, pengon prosperitetin ekonomik të shteteve dhe zvogëlon aftësitë e qeverive për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të shtetasve të tyre". Nën sanksione janë vendosur edhe fëmijët e Krasniqit, Aulona dhe Olti Krasniqi, të cilëve nuk do t'u lejohet hyrja në ShBA.

Guvernatori i BQK-së e njofton presidenten për zhvillimet e fundit në sistemin bankar në vend

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, priti në takim punë guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, i cili e njoftoi për punën e bërë në BQK dhe zhvillimet e fundit në sistemin bankar të vendit.

Në takim u diskutua edhe për procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Byrosë Evropiane që siguron Kartonin e Gjellbër për automjete, si dhe digitalizimin e shërbimeve bankare dhe përkrahjes së ekonomisë e nisma të tjera që lidhen me bankimin e

qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm në Kosovë. Presidentja Osmani ka ofruar mbështetje institucionale për adresimin e sfidave dhe realizimin e objektivave me interes për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës.



Konjufca vlerëson rëndësinë e anëtarësimit sa më të shpejtë të Kosovës në Këshill të Evropës

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premten në takim raportuesen për Komisionin e Çështjeve Politike të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për aplikimin e

Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës, Dora Bakoyannis. Në takim, ndër të tjera, u bisedua për gjendjen politike në vend, me theks të veçantë në proceset integruese të Kosovës, përfshirë anëtarësimin në

Këshillin e Evropës. Kryeparlamentari Konjufca vlerësoi rëndësinë e anëtarësimit sa më të shpejtë të Kosovës në Këshill të Evropës dhe kërkoi mbështetje nga raportuesja Bakoyannis. Bakoyannis e falënderoi

kryetarin Konjufca për pritjen, duke shtuar se raporti faktmbledhës, të cilin do të hartojë pas qëndrimit në Kosovë, do të shërbejë si bazë për vijimin nëpër procesin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.



Mbahet Konferenca III Ndërkombëtare "Navigim në botën e mikrobeve"

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, mori pjesë në konferencën III Ndërkombëtare "Navigim në botën e mikrobeve", organizuar nga Shoqata e Mikrobiologëve në Kosovë. Në këtë konferencë mori pjesë edhe dr. Robert Skov, kryetar i Shoqatës Evropiane të Mikrobiologjisë Klinike dhe Sëmundjeve Ngjitëse, njëherësh kryetar i Qendrës Ndërkombëtare të Zgjidhjeve për Rezistencën Antimikrobike (ICARS) si dhe profesor dr. Lul Raka.

Ministri Vitia ka theksuar se zhvillimet e hovshme të teknologjisë kanë ndërruar tërësisht kahen e diagnozës, parandalimit, kontrollit dhe trajtimit të sëmundjeve ngjitëse. "Sot po jetojmë një kohë sfidash dhe mundësish shëndetësore. Pandemia Covid-19, rezistenca ndaj antibiotikëve dhe zoonozat na rikujtojnë marrëdhënien e ngushtë midis njeriut dhe botës së mikrobeve dhe brishtësinë

tonë ndaj kërcënimeve mikrobike përkundër të gjitha zhvillimeve teknologjike", është shprehur ai.

Gjithashtu, ministri Vitia ka potencuar nevojën për kërkime shkencore, inovacione dhe bashkëpunim, duke u zotuar se qeveria është dhe do të jetë e angazhuar për ta mbështetur komunitetin shkencor dhe për të investuar në të ardhmen e mikrobiologjisë dhe drejtimeve të tjera, pasi që asnjëherë nuk ka qenë më urgjente.

"Në këto kohë kritike, rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar është shumë e lartë dhe qeveria jonë është e përkushtuar për krijimin e mjedisëve që inkurajojnë hulumtimin shkencor dhe bashkëpunimin global", ka theksuar Vitia.

Bashkëpunimi dhe angazhimi gjatë dy ditëve të ardhshme të kësaj konference do të kontribuojë në përparimin e mikrobiologjisë kosovare dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.



Osmani pranoi letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Shqipërisë, Petrit Malaj



PRISHTINË, 3 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pranuar letrat kredenciale nga ambasadori i ri i Republikës së Shqipërisë, Petrit Malaj, të cilin e ka uruar për detyrën dhe ka shfaqur shpresën se gjatë mandatit të tij do të shtohen edhe më tej marrëdhëniet bilaterale në mes të dy shteteve simotra. Sipas presidentes Osmani, bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, sidomos në unifikimin e politikës së jashtme, mbetet prioritet. "Fuqizimi i vazhdueshëm i koordinimit diplomatik është interes jo vetëm i shteteve tona, por edhe i rajonit në tërësi", ka theksuar presidentja Osmani. Më tej, në takim me ambasadorin Malaj, ajo tha se Kosova pret që

Shqipëria të jetë zë i Kosovës në mekanizmat dhe organizatat ndërkombëtare në të cilat aktualisht shteti ynë nuk ka përfaqësim.

Presidentja Osmani, ndër të tjera, e njoftoi ambasadorin Malaj edhe për zhvillimet e fundit në vend, si dhe mbi aktin e agresionit të Serbisë kundër Republikës së Kosovës, me ç'rast Osmani potencoi rëndësinë e adresimit të përgjegjësive të Serbia dhe aplikimit të masave ndëshkuese ndaj saj.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit në fusha të ndryshme të interesit të dyanshëm dhe shtruan nevojën e zbatimit të marrëveshjeve ndërshtetërore të arritura deri tash.

Klinika e Kardiologjisë, me numër rekord të stentimeve dhe koronarografive

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Numër rekord i koronarografive dhe stentimeve janë realizuar nga kardiologët e Klinikës së Kardiologjisë në kuadër të Shërbimit të Kardiologjisë Invazive në QKUK. Ndonëse

jemi në muajin e parafundit të vitit 2023, statistikat flasin se asnjëherë më parë nuk kishte më shumë koronarografi dhe stentime në këtë periudhë kohore, pra rreth 1 000 stentime më shumë, e që në mesatare i

bie rreth 200 stentime në muaj. Statistikat sipas viteve: Viti 2023 - deri tani 2 mijë e123 stentime dhe 3 mijë 91 koronarografi; Viti 2022 - 1 mijë 730 stentime dhe 2 929 koronarografi; Viti 2021 - 1 450 stentime dhe 2 524

koronarografi; Viti 2020 - 1 157 stentime dhe 2 128 koronarografi; Viti 2019 - 1 638 stentime dhe 3 335 koronarografi; Viti 2018 - 1 663 stentime dhe 2 517 koronarografi.



Minatorët e “Trepçës” ndërpresin grevën

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Minatorët e Kombinatit Metalurgjik “Trepça” pas 10 ditësh e kanë ndërprerë grevën. Marrëveshja është arritur në mes të Bordit të përkohshëm të Drejtorëve të “Trepçës” dhe disa deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje pak pas mesnatës. Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet, Mimoza Kusari-Lila, konfirmoi për “Radion Evropa e Lirë” se janë plotësuar disa kërkesa të minatorëve, sikurse pagesat e rregullta mujore. Ndërkaq, sa i përket kërkesës për sigurim shëndetësor dhe jetësor, minatorët janë pajtuar që këto çështje të trajtohen më vonë. Sipas marrëveshjes, minatorët dhe përfaqësuesit e partisë në pushtet u pajtuan që ekzekutimi i pagës së minatorëve të bëhet nga data 6 deri më 10 të çdo muaji, të shpallet konkursi për zgjedhjen e kryeshefit ekzekutiv të Trepçës, të përmirësohen kushtet e sigurisë dhe të tërhiqen vendimet e ndërmarra gjatë grevës 10-ditore. Minatorët hynë në grevë më 24

tetor në kërkim të kushteve më të mira të punës.

Pagat e minatorëve në “Trepçë” sillen nga 700 deri në 900 euro, varësisht përvojës dhe përgatitjes profesionale. Por, muajt e fundit, minatorët i kanë marrë pagat mujore të ndara në dy pjesë. Minatorët nuk kanë sigurime shëndetësore, as jetësore dhe vazhdimisht kanë kërkuar t'i kenë të njëjtat.

Kompleksi Metalurgjik “Trepça” është shoqëri aksionare: 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, 20 për qind janë të punonjësve të kësaj ndërmarrjeje. Deri në vitet '90 kur është përkeqësuar situata politike, ajo është llogaritur si një prej ndërmarrjeve më të mëdha jo vetëm në Kosovë, por edhe në territorin e Jugosllavisë së atëhershme.

Trepça pritet t'i kalojë nën pronësi Fondit Sovran që, sipas Qeverisë së Kosovës, do ta ketë përgjegjësinë ekskluzive për të investuar në rritjen e vlerës së tyre.



“Wizz Air” për të dytin vit radhazi fiton çmimin Capa për qëndrueshmërinë mjedisore

PRISHTINË, 3 NËNTOR - “Wizz Air”, linja ajrore me rritjen më të shpejtë në Evropë, ka fituar për të dytin vit radhazi çmimin Capa, si Grupi Ajror i Vitit për Qëndrueshmërisë Globale Mjedisore, në Samitin e Aviacionit në Kuala Lumpur. Çmimet Capa të Ekselencës në Qëndrueshmërinë Mjedisore shpërblejnë linjat ajrore, aeroportet dhe furnizuesit e tyre, të cilët e vendosin çështjen e ndryshimeve klimatike në krye të agjendës së tyre. Çmimet hulumtohen një nga një në mënyrë të pavarur nga analistët e Capa për zvogëlimin e karbonit dhe nga kompania Envest Global. Capa, pjesë e Rrjetit të Aviacionit, është një nga burimet më të besuara në botë për sa i përket inteligjencës së tregut në industrinë e aviacionit dhe atë të udhëtimeve. “Wizz Air” e fitoi këtë çmim si pasojë e angazhimit të saj të



pandryshuar në fushën e qëndrueshmërisë mjedisore.

Kompania ajrore evropiane më e përkushtuar në tarifata e saj të ulëta operon një nga flotat më të reja të avionëve në botë me nivelet më të ulëta të karbonit, në krahasim me kompanitë e tjera konkurrencte.

Niveli i emetimeve të karbonit të “Wizz Air” ishte 53.8 gramë për pasagjer/km në vitin 2023, e cila tregon një rënie prej 11 % nga një vit më parë.

Për t'i arritur këto nivele të ulëta, kompania ka investuar në flotën e saj, duke zëvendësuar avionët e

vjetër me teknologjinë e fundit Airbus A321neo, të cilët ofrojnë një rënie me 20 % të emetimeve të CO2. Ato ofrojnë 50 % më pak emetime të oksidit të azotit si dhe i reduktojnë me po të njëjtën vlerë nivelet e zhurmës që prodhojnë.

“Wizz Air”, gjithashtu, ka thurur një strategji të qartë për sa i përket karburantit të qëndrueshëm të avionëve (SAF).

Në strategjinë e kompanisë përfshihen marrëveshjet dhe partneriteti me furnizuesit si Mabanaf, Neste, OMV dhe Cepsa.

Për ta mbështetur më tej zhvillimin e karburantit të qëndrueshëm, “Wizz Air” ka bërë investimin e saj të parë me një vlerë prej 5 milionë paundësh në kompaninë “Firefly Green Fuels”, një kompani angleze e karburantit bio. Si pjesë e “Indigo Partners”, “Wizz Air” gjithashtu ka kontribuar në një investim prej 50

milionë dollarësh në kompaninë amerikane të karburantit të qëndrueshëm Clean Joule.

Në maj të vitit 2023 “Wizz Air” u shpall kompania e parë hungareze e cila testoi furnizimin e Aeroportit të Budapestit me karburant të qëndrueshëm dhe ngriti 5 avionë nga Budapesti, të cilët fluturonin me një përzierje prej 35 % të karburantit të qëndrueshëm.

Jozsef Varadi, drejtor ekzekutiv i “Wizz Air”, tha se është një nder i madh ta marrësh çmimin Capa të Qëndrueshmërisë Mjedisore Globale për të dytin vit radhazi. “Kjo është një dëshmi e punës dhe përkushtimit të ekipit të ‘Wizz Air’ sa i përket qëllimit tonë në uljen e niveleve të karbonit 25 % deri në vitin 2030. Ne operojmë avionë me teknologjinë më të fundit në mënyrë më efikase dhe me emetimet më të ulëta për pasagjer/km në industrinë e aviacionit”, ka theksuar ai.

Dështon sërish konstituimi i komisionit hetimor për rezervat shtetërore

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Për herë të gjashtë ka dështuar të konstituohet Komisioni Hetimor për Rezervat Shtetërore për shkak të mungesës së deputetëve të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje.


Kryesuesi i këtij komisioni, Rashit Qalaj, ka thënë se nga zyra ligjore përmes shkresës që i kanë dërguar kanë marrë një opinion, që nuk sqaron asgjë. “Kemi marrë opinion që nuk sqaron asgjë. Është opinion që

shton konfuzitetin. Vetëm janë përmendur detyrimet e deputetëve, por nuk kanë sqaruar se çfarë mund të bëjmë, nëse mund t'i zëvendësojmë deputetët nga partia e njëjtë. Mungesa e kolegëve (të LV-së) po e pamundëson mbajtjen e këtij komisioni. Në mbledhjen e ardhshme do të vendosim nëse do të bartim këtë çështje në Kuvend ose do të vazhdojmë tutje në konstituimin e tij”, tha ai.

Deputeti nga AAK-ja, Pal Lekaj, ka vendosur disa letra, në të cilat ka shënuar pagat e secilit prej këtyre deputetëve që marrin nga Kuvendi. “Paga të majme, ama në punë nuk vijnë. Ditën e nisa me një aksion simbolik në Komisionin Hetimor për Rezervat Shtetërore, ku për të gjashtën herë deputetët e Vetëvendosjes që paguhen nga taksat e qytetarëve nuk vijnë në konstituimin e tij”, ka shkruar Lekaj në “Facebook”.



Stratioti Mërkur Bua Shpata në penelin e Lorenzo Lottos



Nga: Luan RAMA

Fytyra e vetme e Mërkur Bua Shpatës, por dhe e rrallë ndër stratiotët shqiptarë të shekullit XVI,[1] qëndron sot ballë nesh, shfaqur kështu pas thujse pesë shekujsh, duke kapërcyer nëpër mjegullat e historisë. Është portret i fuqishëm e njëkohësisht melankolik, me një tis të lehtë trishti, çka në fillim studiuesit dhe historianët e artit nuk e kuptonin se i kujt ishte ky portret. Për më tepër që Lorenzo Lotto, që e kishte pikturuar këtë portret, nuk e kishte shkruar emrin e stratiotit pas telajos, as datën apo emrin e tij si artist. Kështu, piktura me dimensionet 1.18 metra me 1.05 metra dhe me ngjyra vaji, ishte anonime, me një titull galeristi: “Portret burri” apo “Ritratto di gentiluomo”. Një dritë okër e ndriçon në veçanti fytyrën e stratiotit Mërkur Bua me një beretë të zezë në kokë, portretin e këtij stratioti që edhe pse një figurë heroike e luftërave të Italisë, por dhe në luftërat e Evropës, këtë çast të jetës së tij kishte dy sy të paqtë – por, gjithashtu të lodhur, ndoshta nga luftërat e gjata e të pambarimta. Mund të imagjinosh për një çast stratiotin që ka ardhur në atelierin e piktorit për të pozuar, duke i treguar njëkohësisht historinë e tij, siç ndodhte gjithnjë midis artistit dhe personazhit para tij. Dhe, sigurisht ai duhet të ketë shkruar disa herë në atelierin e

venecianit Lotto, një piktor që punonte shumë me metaforën, simbolin, siç vihet re edhe në këtë tablo.

Në fillimin e viteve 1500, në Itali apo vendet e tjera të Evropës, portrete të tilla bënin mbretërit dhe princat e oborreve mbretërore e të perandorive, si ndodhte me portretet e François I, Louis XII, të Henri IV, Henri VIII, të dozhëve të Venedikut si Loredano etj., të papëve të Vatikanit apo mbretërve të Napolit, princave e markezëve të Milanos (Sforza), Firences, Pizës etj., apo proveditorëve e “condotiere”-ve të principatave italiane, kalorës të mëdhenj, emrat e të cilëve hynë në historinë e madhe të Evropës. E, padyshim një prej tyre ishte dhe Mërkur Bua Shpata (1478-1542), pinjoll i një familjeje të madhe, emrat e të cilëve historiani gjerman Carl Hopf i ka gjetur në librat kishtarë të kohës bizantine dhe ku në krye të dinastisë shqiptare Bua, ai ka vendosur N. N. Bua. Hopf shkruan se emri Spatas gjendet që në vitin 1304, ndërsa Bua në 1333. Bua kishte dy djem, Nikolla, “protovestiaire” (funksionar i lartë në oborrin perandorak bizantin) i Stefan Dushanit (më 1345-1349) dhe Mihali. Biri i Nikollës ishte Petro, zot i Angelokastrës dhe i Delvinës, e kështu me radhë të Gjin Bua Shpata, Zebenishti etj. Dihet që Bizanti që sundonte edhe në shekujt XIII-XIV në Kostandinopojë, bëri zhvendosje popullore, ku mijëra shqiptarë i

dërgoi drejt Artës, Prevezës, Kretës dhe kryesisht Peloponezitet. Sidoqoftë më vonë, emri i Mërkur Buas do të lidhej me bëmat e tij historike si kalorës i shquar në luftërat e Moresë dhe veçanërisht të Venedikut, duke theksuar në veçanti dhe një nga betejat më të famshme siç ishte ajo e Marignanos bashkë me “condotiere”-n venecian Bartolomeo d’Alviano. Por, stratioti shqiptar kishte shërbyer edhe nën flamurin e mbretit të Francës Henri II, edhe të perandorit të perandorisë romano-gjermanike Maksimiliani, të princit Ludovico Sforza të Milanos apo Republikës “Serenissima” të Venedikut ku pritej gjithnjë me nderet më të mëdha. Madje, pikërisht në këtë periudhë, më 1523 ai ishte pritur në mënyrë të bujshme nga dozhi Gritti në Venecie. Bua kishte një trupë të vete të stratiotëve që e ndiqnin nga një luftë në tjetrën. Historianët e artit thonë që kjo pikturë është pikturuar nga Lotto në vitet 1530. Por, kur saktësisht? Piktori nuk e ka shkruar prapa pëlhurës dhe mesa duket letrat shoqëruese kanë humbur si nga librat e piktorit (“Libro di spese diverse”), të cilët në përgjithësi shënonin të gjitha shitjet e pikturave, por dhe në librat e atyre që e blejnë, dhe pikësëpari Bua. Por, si duket, pas vdekjes së Buas, e shoqja e tij e re dhe fisnike nga Treviso, e ka shitur si një punë të Lottos, i cili atë kohë vlerësohej shumë, krahas Ticianit, Boticcellitit,

Giorgiones, etj. Pra, shumë detaje janë të errta, por sidoqoftë mund të themi se kjo vepër e Lottos është ndoshta më e hershme se viti 1530. Pas betejës së Pavis, ku mbreti francez François I u mund dhe u kap rob, në Italinë e veriut pati një lloj qetësie dhe ndoshta pikërisht atëherë duhet të jetë pikturuar dhe kjo tablo. Mërkurio ishte ende një “condotiere” me shumë emër në Venedik. I biri i tij kishte shkruar në shërbim të perandorit Maksimilian ku dhe do të vritej vite më vonë në një nga betejat e famshme të perandorit. Siç dihet, gruaja e parë e Mërkurit, Maria Bokali (Boccali), vajza e bashkëpatriotit të tij Niko Bokali dhe e Katarina Arianitit, krushkë e Skënderbeut, vdiq papritmas në moshë të re në vitin 1524, në Venecie, dhe u varros në kishën e San Biagos të këtij qyteti. Ajo ishte vajza e miqve të tij Bokali, shqiptarë edhe ata të ikur nga luftërat në Morë, kundër osmanëve, kur më së fundi ranë dhe kështjellat veneciane të Greqisë si në Nafplio, apo më parë bastionet e fuqishme venedikase si Qipro e Kreta. Një nga pinjollët e famshëm të Bokalëve vazhdonte të shërbente në gardën e afërt të mbretit François I. Pasi qëndroi pak kohë i ve, Mërkuri u martua me vajzën e një fisniku të pasur nga San Juliano, Alvise Balbi, çka tregohet dhe në unazën e dytë që ka vendosur në gisht. Dora e tij është vendosur në cepin e tavolinës, ku pranë qëndron një kafkë e vogël që të

kujton gruan e tij të vdekur si dhe petalet e zbehta të trëndafilin përreth. Duket sikur ajo dorë i mban pranë ato.

Pikërisht në atë periudhë, nga Roma, Lotto kishte ardhur në Marçes e pastaj në Bergamo dhe Treviso. Vallë tabloja është pikturuar në Marçes apo në Treviso? Imazhi i Trevisos në tablo të sugjeron se është pikturuar pikërisht atje, por nuk është e vështirë për një piktor ta bëjë ilustrimin e një qyteti edhe pa qenë konkretisht në atë vend, mjafton ta ketë skicuar më parë.

Po përse historiani i artit Humphrey e ka datuar këtë tablo në vitin 1535, ndërkohë që mendimi i mëparshëm unanim kishte qenë se Lotto e kishte punuar në vitin 1530? Mjafton të bëjmë një përaftrim me tablonë tjetër të Lottos, “Portreti i argjendarit, i parë në tri këndvështrime”, për të kuptuar se këto dy portrete janë pikturuar në të njëjtën kohë, me të njëjtat ngjyra dhe se janë tepër të ngjashëm. Mjekra e dy personazheve është e njëjtë, madje dhe hunda apo drita e portretit. Është e habitshme të arsyetosh se nuk përkon ky portret me pikturat e tjera të kësaj periudhe. Por ç’janë pesë vjet në krijimtarinë e një piktori? A ndryshon vallë shumë stili i tij brenda pesë vjetëve? Sigurisht që jo, veçanërisht për piktorët e Renesancës...

I pari që flet për këtë portret është historiani Pordenone, i cili i

referohet inventarit të galerisë Borhese në vitin 1790 në Romë. Por, shumë më vonë, në vitin 1952, Della Pergola e identifikon këtë portret të Lottos, duke cituar inventarin e fisnikes romane Olimpia Andobrandini, si “një tablo me pëlhurë e pikturuar nga Lorenzo Lotto dhe që vinte nga koleksioni i xhaxhait të saj, kardinalit Ipolitto Aldobrandini dhe që duhej të ishte një autoportret. Kjo u pranua nga disa historianë, por historianë të tjerë qëndruan skeptikë dhe me rezerva ndaj këtij pohimi, meqë unazat në dorën e personazhit të pikturuar sugjerojnë se ai ka qenë apo është i martuar. Pra, pse ishte pronë e tij s’do të thoshte se në atë tablo ishte vetë ai. Më 1530, Lotto ishte 50 vjeç, por personazhi duket i ri për këtë moshë. Kur shkruhet se është bërë nga “medesimo”, duhet kuptuar se është bërë nga vetë ai, dora e Lottos. Më 1981, historiani tjetër Puppi deklaroi se duhet të jetë portreti i një filozofi okulist e letrar venecian, por kjo dukej e pabazë, siç shkruan dhe studiuesi Peter Humphrey në librin Lorenzo Lotto. Kritiku tjetër i artit, Riccardi, në vitin 1989 deklaroi se ky portret ishte ai i stratotit Mërkur Bua, “condottiere Albanese” në shërbim të Venedikut. Me këtë hipotezë u bashkuan dhe kritikë e historianë të tjerë arti të epokës së Rilindjes siç ishin Beguin (1993).

Tri ishin argumentet e këtyre historianëve e kritikëve: Bua ishte një ushtar që vinte nga Ballkani, pra ai duhej ta kishte adhuruar Shën Gjergjin; se qyteti prapa i ngjan Trevisos, ku Bua ka jetuar dhe ka ngritur madje një shapelë kushtuar Shën Gjergjit në kishën Santa Maria Maggiore, ku dhe u varros në vitin 1541, siç shënohet në pllakën e varrit monumental me një ansambël skulptural të skulptorit italian Agostino Busti, bashkë me mbishkrimin ku jepeshin shërbimet e tij ndaj Venedikut, mbretit të Francës, perandorit të Gjermanisë etj. (Mercurio Bua Comiti E. Principibus Peloponnesi.

Epirotarum Equitum Ductori., Anno Salu. MDCXXXVII), duke vazhduar me shërbimet e tij ndaj pizianëve, Ludovico Sforzas, Papës, perandorit Maximilian apo mbretit francez François I në betejën e Marignanos.

Mërkur Bua ishte luftëtar që lufta e thërriste çdo çast dhe pak qëndronte në Venedik apo në Treviso e Bergamo, Verona, Milano etj. Atdheu i tij i vërtetë ishin vendet ku luftonte. Disa herë kishte ndërmjetësuar pranë Venedikut të vinin forca të reja stratotësh nga Morea dhe nga brigjet shqiptare. Dihet kërkesa këmbëngulëse e Buas ndaj dozhit të Venedikut, që pas tërheqjes së forcave turke nga Korfuzi më 1537, të nisej në krye të një trupe të madhe stratotësh dhe të çlironte Morenë. Por, republika nuk donte të bënte luftë të hapur me Perandorinë Osmane. Kështu, Bua nuk do ta shikonte më vendlindjen e tij dhe atdheun e të parëve. E vetmja gjë që e lidhte me atdheun e tij ishte tashmë vetëm gjuha, besimi (kisha ortodokse) dhe miqtë e tij besnikë stratotë. Vitet e fundit Mërkur Bua kishte



vazhduar luftërat kundër spanjollëve, madje dhe kundër gjermanëve apo trupave të Brunauikut: në nëntor të vitit 1526, ishte “condottiere” Francesco Maria Della Rovere (Tiziano i ka bërë ndërkohë atij portret të mrekullueshëm) që i kërkon të luftojnë kundër gjermanëve në Frundsberg; më 1527 mbron Bergamon me proveditorin venecian Domenico Cantarini; në shtator të atij viti sulmon në Pavia; më 1529, “Consiglio des Savi” e emëroi Buan guvernator të Rovenas: 250 stratotët e tij i çon të çlodhen në Treviso dhe 62 të tjerë në Padovë; më 1531 i kërkon “Coollegio”-s së dozhit të Venedikut që nëse vdes, “trupa e tij t’i jepet ta komandojë i biri me të njëjtat ndere e shpërblime”; më 1532 e gjejmë të vendosur përfundimisht në Treviso dhe shtëpia e tij është pranë kishës San Nicolo.

Një nga takimet interesante dhe të fundit të Mërkur Buas ishte dhe ajo e vitit 1541, kur ai priti dhe përçolli drejt Francës ambasadorin francez që vinte nga Stambolli, fisnikun Antoine Rincon, bashkë me

ambasadorin tjetër të mbretit François I, Cesare Fergoso. Por, kur ata të dy kishin kaluar lumin Po dhe ishin ndarë me Buan, më pas ishin vrarë pabesisht nga guvernatori i Milanos. Ishte fundi i vitit 1541. Tashmë Bua nuk ishte më në moshë të përdorë shtatën si dikur, nuk ishte në gjendje të rendë majë kalit e të luftonte në këmbë me heshtën e gjatë të tij.

Nga stratotët e tjerë, kronistët mesjetarë, veçanërisht ata të epokës së “Luftërave të Italisë”, përmendin dhe Alessio Buan apo stratotin tjetër Pradano Bua, nipi i vet Mërkur Buas. Alessio apo Aleks, kishte ardhur në Venedik nga Nafplio e Moresë, në vitin 1509, dhe më vonë kishte luftuar në Veneto, në krye të 30 stratotëve (1510); në Mestre, në krye të 130 stratotëve etj. Në Veneto, gjatë një beteje ai u kap rob, por shumë shpejt u shkëmbye me robin kundërshtar Francesco Maldonaldo. (1511). Alessio ka marrë pjesë në mbrojtjen e Venetos në vitin 1514 dhe vdiq në vitin 1526. Lidhur me Prodano Buan, ai shërbeu në fillim në ushtrinë e

Federico Gonzagas dhe më pas u bashkua me trupën e Mërkur Buas. Në fillim ai i printe një skuadre prej 15 stratotësh, por në Crema e gjejmë në krye të gjashtëdhjetë stratotëve shqiptarë. Mori pjesë në luftën për pushtimin e Pavis në vitin 1528 dhe vdiq në vitin 1540, pra para se të jepte frymën mbrojtësi dhe idhulli i tij Mërkur Bua, bëmat e të cilit do të përshkruhen nga shumë historianë të mesjetës italiane e frënge, veçanërisht për “Luftërat e Italisë” në fundin e shekullit XV dhe fillimin e shekullit XVI.

Lorenzo Lotto vdiq në vitin 1557, pra 15 vjet pas Buas, duke lënë pas tij vepra të jashtëzakonshme, tablo dhe afreske si “Virgjëresha me fëmijët”, “Triumfi i Virgjërisë”, “San Jeronimi” ... apo afreskun gjigand të vendosur në shapelën e Suardit në Treskore, “Krishti – hardhia e Zotit”. Gjithashtu, një nga tablo e tij “Portreti i Lucina Brembatit” (por edhe tri të tjera) gjendej në koleksionin tepër të pasur të familjes Albani në Urbino, të cilën zonja Grumelli Albani e kishte shitur në vitin 1882. I pari që

tërhoqi vëmendjen ndaj pikturës së Lottos ishte specialist amerikan i “primitivëve italianë”, Bernard Berenson. Pesëqindvjetori i lindjes së piktorit më 1980 dha mundësinë e një ekspozite të madhe retrospektive në Uashington, Paris dhe Bergamo, ku u ekspozua dhe portreti i Mërkur Buas, stratotit të famshëm shqiptar.

Duke shkruar këto radhë, mendoj gjithashtu se do të ishte e udhës që të kishim një kopje të kësaj tabloje në Muzeun Historik Kombëtar, ku kontributi i stratotëve shqiptarë më së fundi të gjejë vendin e vet, pasi është pjesë e kontributit shqiptar në mbarë kontinentin evropian. Dhe, për këtë nuk mungojnë as dëshmitë historike, botimet, portretet, as emrat e imazhet e tyre, as bëmat e tyre të mëdha.

[1] Një tablo e bukur ekziston edhe mbi stratotin tjetër të famshëm, Giorgio Manessi, duke ecur në një fushë beteje dhe duke tërhequr pas kalin e vet. Po kështu, së fundi janë gjetur edhe disa portrete stratotësh në një muze të Londrës.

Bukuria më e madhe ndonjëherë lind nga vuajtjet dhe fatkeqësitë



Nga: Guendalina MIDDEI
Përktheu: Beti NJUMA

Kush nuk e ka dëgjuar së paku një herë në jetë, Simfoninë e Nëntë? A e dini se Beethoveni e shkroi këtë kryevepër pasi humbi dëgjimin? Kjo muzikë e jashtëzakonshme, një nga më të famshmet në botë, të drithëron nëse e kupton historinë që fshihet pas saj. Sidoqoftë, jo të gjithë e dinë se emri

tjetër i simfonisë është "Himni i gëzimit". Në momentin më të errët të jetës së tij, Beethoveni kompozoi një vepër që është një himn për gëzimin, për shpresën. Çfarë na thotë Beethoveni? Se bukuria më e madhe ndonjëherë lind nga vuajtjet dhe fatkeqësitë. Nëse lexoni biografite të njerëzve të mëdhenj, do të gjeni një rënie, një moment dëshpërimi të tmerrshëm, një pengesë aq të madhe sa dukej e pamundur për t'u kapërcyer. Van

Goghu u mbyll në një spital psikiatrik, Dostojevski u dënua me punë të detyruar, Beethoveni u shurdhua ... Megjithatë, pikërisht në atë moment ai kompozoi muzikën më sublime dhe ka një arsye pse veprat e tij vazhdojnë të zgjojnë emocione kaq të forta. Sepse, na tregojnë historinë e një shpirti që reziston dhe shkëlqen edhe në errësirë. Një gazetar pyeti një herë Michael Jordanin se si u bë një nga basketbollistët më të mëdhenj në

botë. A e dini si u përgjigj? "Sepse nuk u dorëzova kurrë. Derisa luaja në NBA, kam humbur nëntë mijë guajtje". Basketbollisti më i mirë në botë e ka humbur koshin nëntë mijë herë. Por, kjo s'përbën problem, sepse të bësh gabime nuk do të thotë të dështosh, dështon vërtet vetëm kur dorëzohesh. Dhe kështu bëri kompozitori i madh. "Dua ta mbërthej fatin për fyti", kështu shkruante Beethoveni në ditarët e tij, kur tashmë e kish

humbur dëgjimin dhe i godiste tastet e pianos aq dhunshëm sa që e shkatërroi vetëm e vetëm për të dëgjuar tingujt e prodhuar nga duart e veta. "Nuk dorëzohem, nuk dorëzohem", kështu tha! Dhe, sa më shumë përparonte sëmundja dhe bota bëhej për të një varrezë tingujsh, aq më shumë muzika e tij arrinte nivele hyjnore. Dhe, nuk ishin klithma dëshpëruese dhe ankuese ato që ai lëshonte, por klithma të furishme triumfi.


MOS HARRO

Poezi nga: Charles BUKOWSKI
Përktheu: Fadil BAJRAJ


se gjithmonë është dikush apo diç që të pret,
diç më e fortë, më inteligjente,
më djallëzore, më e përzemërt, më e durueshme,
diç më e madhe, diç më e mirë,
diç më e keqe, diç më
sy si të tigrin, nofulla si të peshkaqenit,
diç më i krisur se vetë i krisuri,
më i mençur se vetë i mençuri,
gjithmonë është dikush apo diç që të pret,
derisa i mbathë këpucët
ose derisa flenë
ose derisa e zbrazë koshin e plehrave
ose e përkëdhel macen
ose i lanë dhëmbët
ose kremton festë
gjithmonë është dikush apo diç që të pret,

mbaje mend mirë këtë
ashtu që kur të ndodhë
do të jesh i gatshëm po aq sa është e mundur.

në ndërkohë, e bëfsh ditën e mirë
nëse je ende aty.
kujtoj se ende jam –
bash sapo i dogja gishtat me këtë
cigare.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Invert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Khudistet i sjellin Kosovës dy medalje nga Franca

Kampionet Olimpike, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova i kanë siguruar Kosovës medalje në evropianin e xhudos që po mbahet në Francë. Distria fitoi medaljen e medaljen e argjendtë, derisa Nora e fitoi medaljen e bronzitë

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Xhudo mbetet sporti kryesor në Republikën Kosovës. Dy xhudistet kampione olimpike, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova i kanë siguruar Kosovës dy medalje në Kampionatin Evropian të xhudos që po mbahet në Montpellier të Francës. Distria Krasniqi e fitoi medaljen e medaljen e argjendtë në kategorinë deri në 52 kilogramë, ani pse ishte dominuese në finale ishte një pakujdesi që i kushtoi me humbje nga xhudistja franceze, Amandine Buchard. Paraprakisht Distria arriti me tri finale deri në finale. Në raundin e dytë e mposhti me kroatën Ana Viktorija Puljiz, kurse në çerekfinale eliminoi xhudisten nga Azerbajxhani, Gultaj Mammadaliyeva. Në gjysmëfinale, Distria Krasniqi triumfoi ndaj italianes, Odette Giuffrida. Në anën tjetër edhe Nora Gjakova ishte e suksesshme duke e fituar medaljen e bronzitë në Kampionatin Evropian. Gjakova mposhti gjermanen Seija Ballhaus, në garën e saj për medaljen e bronzitë në kategorinë deri në 57 kilogramë. Për të arritur deri në repesazh mposhti polaken Arleta Podolak, në çerekfinale, xhudisten kosovare e mposhti gjermania Pauline Starke. Raundin e parë të repesazhit, Nora e kaloi pa luftë, pasi izraelitja Timna



Nelson Levy nuk doli fare në tatami. Pas këtij suksesi ka reaguar edhe trajneri i xhudos, Driton Kuka. "Tashmë 11 vjet me radhë Kosova me medalje nga Kampionatet Evropiane elitare! 21 medalje Evropiane për të rritur. Të shtunën shkojmë tutje, kemi ende aduta!", ka deklaruar Kuka. Të premtën

ka garuar edhe Flaka Loxha e cila ka pësuar humbje në raundin e dytë të Kampionatit Evropian të xhudos për senior. Në kuadër të kategorisë deri në 57 kilogramë, Loxha u mposht në raundin e dytë nga Marica Perisq. Në raundin e parë, Loxha e mposhti xhudisten bullgare, Ivelina Ilieva.

SHKURT

'Marca': Dribluesi më i mirë në Evropë është Zhegrova

Nuk është Mbappe, Vinicius apo Rafael Leao dribleri më i mirë në Evropë. Ky epitet për moshën mbi 23 vjeçe i takon Edon Zhegrovës, raporton "Marca". Të paktën kështu thotë "Indeksi" i përgatitur së bashku nga "Wyscout" dhe "CIES Football Observatory" mes lojtarëve që kanë luajtur të paktën 450 minuta në pesë ligat kryesore. Anësori i majtë i Lilles ka përfunduar me sukses 27 nga 44 driblimet që ka tentuar në Ligën 1. Domethënë, ai ka një përqindje suksesi prej 61.36 %. Reprezentuesi i Kosovës shkëlqeu në fitoren e fundjavës së kaluar ndaj Monakos (2-0). Golat e Diakite dhe Ivan Cavaleiro "lindën" nga këpucët e tij.

Asllani: Ëndërrim për në Gjermani, tifozët na kanë ndihmuar shumë

Mesfushori i Kombëtare sonë Kristjan Asllani ka dhënë së fundmi një intervistë për "Ora News", në të cilën ka folur për ëndrrën për të shkuar në Evropian. Ai ka thënë se do të bëjë të pamundur që kombëtarja jonë të kualifikohet për në "Euro 2024" në Gjermani. "Qysh kur kemi filluar sezonin me Kombëtaren ka qenë një ëndërr. Të gjithë ëndërrim për në Gjermani. Kemi një ndeshje të vështirë në Moldavi. Është normale se e mendojmë fitoren, por në futboll nuk i dihet asnjëherë. Jemi shumë të fokusuar dhe do të luftojmë për bluzën dhe fitoren. Na ndihmojnë shumë tifozët. Kur luan këtu në 'San Siro' është fantastike. Ndërsa edhe në Shqipëri është fantastike. Edhe lojtarët e tjerë thonë se është një atmosferë që nuk është parë ndonjëherë", ka deklaruar Asllani.

Për pak orë shiten biletat e ndeshjes Shqipëri - Ishujt Faroe

Biletat e ndeshjes Shqipëri - Ishujt Faroe janë shitur të gjitha në vetëm pak orë. Federata Shqiptare e Futbollit nxori njoftimin mbrëmjen e së enjtes se të gjitha biletat për duelin e rëndësishëm në Tiranë më 20 nëntor kanë "avulluar" në kohë rekord. Edhe pse përballë vendit të fundit në grup, kjo ndeshje do të jetë e rëndësishme për Shqipërinë si takimi i fundit në grupet kualifikuese. Çmimet e biletave silleshin nga 3 000 lekë më e lira, deri në 8 000 lekë më e shtrenjta. Kombëtarja shqiptare udhëton fillimisht në Moldavi më 17 nëntor, ku edhe atje pritet të jetë një stadium i tejmbushur, ndërsa 3 ditë më vonë pret në Tiranë Ishujt Faroe.

Përballje interesante në Superligën e basketboll

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e shtatë në Prince Caffè Superligë, apo përfundimi i rrethit të parë prej shtatë xhirosh. Vëllaznimi pas dy fitoreve radhazi do të përballlet me Sigal Prishtinën, që numëron katër fitore e dy humbje. Kuqezinjtë synojnë fitoren e tretë radhazi, kurse prishtinasit të pestën këtë edicion. Takim shumë i rëndësishëm shihet ai ndërmjet Proton Cable Prizrenit dhe Istogut, ku të dy skuadrat kanë nga një fitore e pesë humbje, andaj është shumë i vlefshëm, si për prizrenasit, ashtu për istogasit. Të dielën do të përballen Trepça dhe



Golden Eagle Ylli. Mitrovicasit që po garojnë në FIBA Europe Cup kanë pesë fitore dhe vetëm një humbje nga Peja, ndërsa ish-kampionët e Kosovës kanë dy fitore e katër humbje. Java e shtatë mbyllet me derbin në mes të Pejës dhe Bashkimit, dy skuadra me traditë në

basketbollin e Kosovës. Verdhezinjtë që kanë shënuar edhe dy fitore në FIBA Europe Cup janë të motivuar për fitoren e radhës, ku në garat e elitës kanë gjashtë fitore e asnjë humbje, ndërsa prizrenasit kanë tri fitore e tri humbje.

SUPERLIGA - Java 7

Të shtunën takohen:

17:00 Vëllaznimi - Sigal Prishtina

19:00 Proton Cable Prizreni - Istogut

Të dielën takohen:

17:00 Trepça - Golden Eagle Ylli

19:00 Peja - Bashkimi

Leclerc: Më mirë një fitore në garë sesa të arrij 'pole position' dhe të humbas

SAO PAOLO, 3 NËNTOR - Edhe pse këtë sezon të Formula 1 ka arritur të çojë disa herë makinën Ferrari në "pole position", piloti monogask Charles Leclerc nuk ka mundur të fitojë. Madje piloti i "kokëkuqes" nuk ka një marrëdhënie të mirë me "pole position", pasi në shumicën e

rasteve që është nisur i pari nuk e ka fituar garën. "Ritmi i garës është ende një ngërç për ne. Kam siguruar 'pole' në dy garat e fundit, por s'ka mjaftuar për të fituar. Përparësi për ne mbetet dita e diel, pasi aty duhet të bëjmë sa më shumë pikë. Do të pëlqejë të mbërrija i pari në garë dhe jo në provat

zyrtare", u shpreh nga Brazili, Charles Leclerc. "Duhet të gjejmë disa paraqitje të mira, që të na japin fitoren në garë. Është e vështirë të parashikosh se si do të shkojë një fundjavë, sidomos kur në mes janë edhe garat sprint. Provat e lira janë të rëndësishme për të grumbulluar sa më shumë

informacion", ka pohuar Leclerc. "Në garën sprint, nëse bën një gabim në përshtatjen e makinës, nuk mund të rikuperosh më. Mua më pëlqen ky format. Kjo fundjavë në Brazil është e gjatë dhe e vështirë. Na duhet të rikuperojmë sa më shumë pikë për t'iu afruar Mercedesit, që



është favorit këtu", ka deklaruar Leclerc.

Lumbardh Dellova, 'Ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ndarjen e çmimit "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 12-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Ballkani, Lumbardh Dellova. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje: Flamur Sinani, Lulzim Rrmoku e Bujar Asllani. Ky komision vendosi që qendërmbrojtësi i FC Ballkani, Lumbardh Dellova, të shpallet "Ylli i Javës", pasi ai me golin e tij vendosi fituesin e derbit të xhiros kundër FC Drita me rezultat 1-0. E pikërisht goli i Dellovës i mundësoi FC. Ballkani ta forcojë pozitën e parë në renditje. Portokallezintjët vazhdojnë të mbesin të pamposhtur në këtë edicion. Çmimin "Ylli i javës" për futbollistin e FC Ballkani, Lumbardh Dellova, e ndau Andi Sadiku, dizajner grafik në Albi Group. Pasi mori këtë çmim



qendërmbrojtësi u shpreh i lumtur për fitoren dhe për vlerësimin si më i miri i xhiros. "Jam shumë i lumtur për fitoren dhe për golin që e shënova në derbi. Ndeshja ishte e mirë duke pasur parasysh që ishim të lodhur pak si ekip, por e rëndësishme ishte t'i marrim tri

pikë dhe jemi shumë të lumtur. Jemi që dy vjet me trajnerin Daja, nga eksperiencia e të cilit kemi mësuar shumë. Duhet çdo ndeshje të futemi të motivuar, të bëjmë një hap drejt klubeve evropiane", ka thënë Dellova për faqen zyrtare të FFK-së.

San Antonio e Orlando triumfojnë jashtë fushës, zhgënjejnë Toronto dhe Phoenixi

PHOENIX, 3 NËNTOR - Skuadra e San Antonios fitoi 121-132 në fushën e Phoenixit, sukcesi i tretë sezonal për Spursin, që më në fund shijon të riun Wenbanyama. Debutuesi në NBA realizoi 38 pikë e 10 rebounde për San Antonion, duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e Bookerit dhe 28 të Kevin Durantit. Ekipi i Philadelphia's ndodhet mes ekipeve lidere në Lindje, duke fituar me shifrat 114-99 ndaj Torontos. Embiid me 28 pikë, Oubre e Harris me nga 23 pikë secili, bënë dallimin në fushë për



Philadelphia. Për miqtë u dallua Barnesi me 24 pikë, por që s'mjaftuan për të fituar. Fiton edhe skuadra e New Orleansit, që mundi me rezultat 125-116 Detroitin, ndeshje me rivalitet, ku McCollum

me 33 pikë ishte lider në fushë për vendasit. Orlando, falë 30 pikëve të Bancheros, mundi me rezultat 115-113 Utah Jazzin në sekondën e fundit, duke ngjitur shkallët në Konferencën e Lindjes.

REZULTATET

Philadelphia - Toronto	114-99
New Orleans - Detroit	125-116
Utah Jazz - Orlando	113-115
Phoenix - San Antonio	121-132

NBA në zi, ndahet nga jeta basketbollisti 37-vjeçar

Është ndarë nga jeta në moshën 37-vjeçare Anthony Johnson, një lojtar me një karrierë të shkurtër basketbollisti, por me një moment historik në kampionatin e universiteteve. Lajmi për

vdekjen e Anthony Johnson ka përhapur zi në basketbollin amerikan. Ish-asi i NCAA dhe Montana Grizzlies kishte qenë në gjendje kritike që kur pësoi një goditje masive gjatë festës së

ditëlindjes së vajzës së tij më 21 tetor. Johnson dhe gruaja e tij kanë tre fëmijë së bashku dhe një tjetër që do të lindë së shpejti. Johnsoni nuk pati një karrierë të gjatë basketbollisti dhe nuk njihet për

publikun e gjerë, por në Amerikë ishte ylli i një momenti historik që nuk harrohet kurrë. Në vitin 2010 ai la në hije yllin e NBA-së, Damian Lillard, në finalen e Big Sky Tournament për të hyrë në

Tumeun Final të NCAA. Johnson shënoi 42 pikë kundër yllit aktual të Bucks, Weber State, duke e çuar ekipin në një kthesë të pamundur për të fituar përfundimisht më pas me shifrat 66-65.

SHKURT

Bellinghami: Numri pesë për nder të Zidanes, futboli po më ndihmon

Jude Bellingham po luan sezonin e tij të parë te Real Madridi. Ylli i njohur po tregon klasën e tij, duke qenë protagonist që në fillim të edicionit. "Kam parë se si shumë njerëz afër meje kanë marrë drejtimin e gabuar. Nëse e do futbollin atëherë mendon vetëm për lojën, jo për vëmendjen dhe famën që vjen nga pas. Nëse përkushtohesh te futboli atëherë do të vijë edhe shpërblimi i merituar. Fanella me numër pesë? Është për nder të Zidanes. Edhe pse unë dua ta ndjek rrugëtimin tim, më duket sikur jam duke e rimodeluar sipas shijes sime. Po e bëj këtë numër ashtu siç dua, shumë modern", ka thënë Bellingham.

Ajaxi fiton pas 11 ndeshjesh dhe dy muajsh

Në ndeshjen që ishte shtyrë nga xhiroja e tretë e kampionatit holandez të futbollit, Ajaxi ka mundur Volendam me rezultat 2-0, duke shënuar fitoren e parë në 11 ndeshjet e fundit. Pasi regjistroi shtatë humbje dhe tri barazime në dhjetë ndeshjet e fundit në të gjitha garat, duke u zhytur në fund të Eredivisie, Ajaxi nën drejtimin e trajnerit të ri John van't Schip mposhti Volendam. Ishte një fitore e vështirë, vendasit kaluan në avantazh në minutën e 57 me golin e Steven Bergwijn, ndërsa Chuba Akpom konfirmoi fitoren në minutën e 89. Ishte fitorja e parë e Ajaxit pas gushtit ku fitoi 4-1 si mysafir ndaj Ludogoretsit në "play-off"-in e Ligës së Evropës, ndërsa hera e fundit që fitoi në kampionat ishte në ndeshjen e turit të parë ndaj Heraclesit të luajtur më 12 gusht. Ajaxi për herë të parë në historinë e klubit u takua me Volendam në vendin e fundit të tabelës dhe me tri pikë u ngjiti në pozitën e 15 dhe tani ka tetë pikë.

Neymari kryen me sukses një nga ndërhyrjet më të vështira

Neymari iu nënshtrua ditën e enjte ndërhyrjes kirurgjikale në gjurin e majtë teksa u lëndua në ndeshjen e Brazilit ndaj Uruguait më 17 tetor. Ylli i "Selecaos" dëmtoi meniskun dhe ligamentin, ndaj operacioni ishte i vështirësisë maksimale dhe zgjati plot katër orë. Ishte doktori i kombëtares, Rodrigo Lasmar, ai që mori përsipër këtë ndërhyrje që në fund u cilësua e suksesshme. 31-vjeçari që sapo ishte transferuar në Arabinë Saudite tek Al-Hilal pritet të mungojë për një periudhë të konsiderueshme e cila varion nga gjashtë muaj deri në një vit. Me shumë gjasa, Neymari do të humbasë edhe Kupën e Amerikës e cila zhvillohet në qershorin e vitit 2024 në Amerikë. Dëmtimet kanë qenë një problem i madh për Neymarin në sezonet e fundit dhe nuk e kanë lejuar të shprehet lirisht në fushë. Ky i fundit ishte padyshim një nga më të rëndët që ka pësuar sulmuesi pasi bëhej fjalë për një dëmtim të dyfishtë.



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria –Vlada-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
 AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1181 /1
 Dt: 03.11.2023

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Ligjit nr.08/L- 197 për Zyrarët Publik, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPALLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendit të lirë në Qendra e Kompetencës në Skenderaj për vitin shkollor 2023/2024

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vend i lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e matematikës (20 orë mësimore)	Vend i lirë

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në Shkollë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit, duhet të jenë të vërtetuara ose noterizuara;
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me komizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Matematikë në shkollë të mesme të lartë:

- Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katërvjeçar;
- Bachelor (katërvjeçar 240 ECTS).

III. Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silltet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjisllacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

IV. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2023/2024 (Shtator 2023 – Gusht 2024);
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri në 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjedhjen në pozitë e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail (konkurset) dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në tabelën e shpalljeve në Shkollë dhe do të dërgohen kandidatëve me e-mail.

V. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: 03.11. 2023 deri më datën 17.11.2023.
- Aplikacioni merret dhe dorëzohet në Shkollë, Qendra e Kompetencës në Skenderaj;
- Dokumentet e pakompletuara si dhe ato pas afatit, nuk merren në shqyrtim.
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHTI;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;
- Rezultatet e konkursit do të publikohen në tabelë të shpalljeve në Shkollë.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Silva” SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 810243072 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Silva” D.O.O. od Djakovice, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 810243072 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Silva” L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 810243072 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Shërbimi pronësoro juridik – Komisioni për Shpronësim
Direktorijati za Urbanizam, Katastar i Zastitu Zivotne Sredine
- Imovinska pravna sluzba – Komisija za Eksproprijaciju

06. Nr.464/01-4276/21
Date 09.03.2021

Drejtoria për Urbanizëm, Katastar dhe Mbrojtje të Mjedisit-Shërbimi Pronësoro-Juridik, duke vepruar sipas Vendimit të KK-së Dragash 01 Nr.060/01-1311/1 të dt.29.01.2021, me qëllim të shpronësimit për destinim të ndërtimit të objekteve arsimore (Institucioni parashkollor dhe oborri i shkollës) në fsh.Zgatar, Komuna e Dragashit, në lëndën e shpronësimit Nr.06-464/01-4276/2021 në kuptim të nenit 4,8,9, dhe10, të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës se Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205, me datë 31.10.2023.merrë :

VENDIM PRELIMINAR

1. Miratohet Shpronësimi për interes publik i pronës të paluajtshme të pronareve dhe zotëruesve të interesit që preken nga Shpronësimet për interesin publik, për shfrytëzim të pronës për ndërtimin e objekteve arsimore (objekti parashkollor dhe oborri i shkollës),për nevojat e Komunës së Dragashit në fsh.Zgatar e cila sipas Vendimit është shpronësimi i ngatres kadastrale në tërësi, me të dhëna nga elaborati/evidences kadastrale siq vijon :

Objekti i Shpronësimit: ngastra kad. P-706040016-00982-0 në tërësi, ZK Zgatar me kulturë livadhë i klasës 2, sipërfaqja 13939 m2 , që në elaboratin kadastral evidentohehet në emrin: **Bashkësia Islame E Republikës Kosovës – Këshilli i Bashkësisë Islame në Dragash.**

2.Obligohet Komisioni për Shpronësim qe brenda 5 (pese) ditëve të punes, pas nënshkrimit te ketij Vendimi Preliminar, ti njoftoj pronaret dhe pretenduesit e tokave te cilat do te Shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 (dhjet) diteve të punes pas miratimit te njejtin do ta shpalle ne Gazeten Zyrtare te Kosovës dhe një gazet me tirazh te madhë ne Kosovë;

3.Kundër ketij Vendimi, apo cilës do pjese të tij kane të drejte të paraqesin ankese brenda (15) diteve kalendarike ne Gjykatën Themelore Prizren-dega në Dragash, subjekti kerkuës dhe cilido person i cili është pronar ose zoterues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim;

4. Për zbatimin e ketij Vendimi obligohet Drejtoria për Urbanizëm...-Shërbimi Pronësoro-Juridik;

5.Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare te Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madhë në Kosovë.

Shef i Komunitetit:
Dhjet Xheladini

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Municipality Dragas
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

06 BR . 464-01-4276/21
DAT. 09.03.2021

Direktorat za Urbanizam,Katastar- Imovinsko Pravna Sluzba u skladu sa Odlukom SO dragas 01br.060/01-1311/1 dana 29.01.2021 u svrhu eksproprijacije za gradnju objekta obrazovanja (Objekat predskolski i dvoriste skole) u selo Zgatar,Opština Dragas,u predmetu eksproprijacije 06 BR . 464-01-4276/21 u skladu sa clanom 4,8,9 i 10 Zakona br 03/L139 o Eksproprijaciji nepokretne imovine , sa izmenama i dopunama izvršenim Zakonom br 03/L205, dana 31.10.2023 donosi:

PRELIMINARNU ODLUKU

1.Odobrava se eksproprijacija u svrhu javnog interesa, nepokretne imovine vlasnika ili posednika interesa koji su pogodjeni eksproprijacijom za javni interes,radi koriscenja imovine u svrhu gradnje objekta obrazovanja (objekat predskolski i dvoriste skole) za potrebe Opštine Dragas u selo Zgatar koja po Odluci je eksproprijacija parcele u celini,sa podacima od elaborata parcele koja glasi:
Predmet Eksproprijacije: kadas.parcela P-706040016-00982-0 u celini.KZ.Zgatar sa kulturom Livada 2. Klase u površini 13939 m2,koja u kadastrsko elaboratu evidentira na ime: ISLAMSKA ZAJEDNICA REPUBLIKE KOSOVA-ODBOR ISLAMSKE ZAJEDNICE U DRAGASU.

2. Obavezuje se Opština Komisija za eksproprijaciju da unutar roka od 5 (pet) radniha dana nakon potpisivanja ove Preliminarne Odluke, da obavesti vlasnike odnosno posednike parcela koje ce se eskrporpiosati, a u roku od 10 (deset) radnih dana nakon usvajanja ove odluke, ista ce se objaviti u Sluzbenom Listu Kosova i u jednoj o najtiraznijih dnevnih novina na Kosovu;

3. Protiv ove Oluke ili biko kojeg njenog dela moze se upoutiti zalba unutar roka od 15 kalenadarskih dana, Nadleznom Sudu, od strane pzodnosioca zahteva za eksproprijacijom i bilo kojeg lica – vlasnika ili posednika intersa nad nepokretnom imovinom pogodjenom ovom Odlukom;

4. Za provodjenje ove Odluke je naldezna Direktorat za Urbanizam...Imovinsko Pravana Sluzba;

5. Ova Odluka stupa na snagu danom objavljivanja u Sluzbenom Listu Kosova i u jednim od najtiraznih novinama na Kosovu .

Predsednik Opštine:
Dhjet Xheladini

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fahrije Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I- VIII shfmu "Mati Logoreci" Prizren.
- Andi Elshani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Abdul Frasheri" Prizren.
- Liridon Hoti shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.
- VILDANE HAJZERI, shpall te pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës se mesme "HASAN PRISHTINA".
- QERKIN ISMAJLI, shpall te pavlefshme certifikatën e lëshuar nga Qendra e Aftësimin Profesional Mitrovicë-kursi kuzhinier me numër: 99/2009.
- Konditoria SH.P.K, shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 810549355.
- Valmie Rogomaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat shkollës së mesme Teknike " Nexhmedin Nixha".
- Leonora Ternava shpall të pavlefshme diplomën e Bachelorit të Kolegjit AAB- Prishtinë.
- Bajram Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I, II SHFMU "Leke Dukagjini" Prizren.
- Murat Duraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl X, XI, XII, XIII dhe diplomën SHME "Ymer Prizreni" Prizren.
- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

